

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**ORANGE PLUS SHPK.**

Sot me date 8 Prill 2019 (dymije e nentembehjete), ne Tirane, une i nenshkruari, Gjergj Skendaj, shtetas shqiptar, lindur me 29 Gusht 1981, ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportës me numer BI0603611, banues ne Rr. Dervish Hima nr. 1, Tirane, me vullnetin tim te plote dhe lire, permes ketij akti, themeloj nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne perputhje me legjislacionin ne fuqi te Republikes se Shqiperise dhe sipas kushteve te percaktuara ne kete Akt Themelimi dhe ne Statut.

NENI 1

THEMELIMI DHE EMERTIMI

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar Orange Plus Shpk., (me poshte e quajtur "Shoqeria") themelohet ne perputhje me ligjin shqiptar nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.

NENI 2

PERSONALITETI JURIDIK

Shoqeria fiton personalitet juridik me regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne Tirane, Shqiperi.

NENI 3

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria ka per objekt dhe qellim te saj aktivitetet e meposhtme:

- i. Bar-kafe-restorant;
- ii. katering dhe shpërndarje ushqimesh;
- iii. promovim aktivitetesh te ndryshme per persona te trete brenda dhe jashte territorit shqiptar;
- iv. organizime eventesh, konferencash, seminaresh, takimesh per persona te trete brenda dhe jashte territorit shqiptar;
- v. konsulence ne fushën e hotelerisë-kafeterise-restoranteve;
- vi. asistence ne secilin nga hapat dhe veprimet e nevojshme per te arritur qellimet e lartpermendura.

Ne pergjithesi, Shoqeria mund te kryeje cdo veprimtari te nevojshme e te dobishme, te lejuar nga ligji per realizimin e objektit te aktivitetit te saj.

NENI 4

SELIA

Selia e Shoqerise ndodhet ne adresen: Rruga Dervish Hima, nr. 1, Tirane, Shqiperi. Shoqeria mund te hape dhe te kryeje aktivitet ne vende te tjera, brenda territorit te Republikes se Shqiperise.



NENI 5

KOHEZGJATJA

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar.

NENI 6

ORTAKET

Ortaku i pare i Shoqerise eshte:

(A) Z. Gjergj Skendaj, shtetas shqiptar, lindur me 29 Gusht 1981, ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes me numer BI0603611, banues ne Rr. Dervish Hima nr. 1, Tirane.

NENI 7

KAPITALI

Kapitali themeltar i Shoqerise eshte 100.000 Leke (njqind mije Leke) i cili do te perbehet nga 1 (nje) kuote.

I gjithë kapitali themeltar eshte nenshkruar nga Ortaku i Vetem.

NENI 8

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Pasuria, veprimtaria dhe aktiviteti i Shoqerise do te administrohet nga nje ose me shume administratore.

Administratoret do te perfaqesojne Shoqerine ne perputhje me kompetencat dhe afatin e emerimit qe u jane dhene ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise dhe Statutin e Shoqerise.

Administratori i pare i Shoqerise eshte:

- Gjergj Skendaj, shtetas shqiptar, lindur me 29 Gusht 1981, ne Tirane, Shqiperi, mbajtes i pasaportes me numer BI0603611, banues ne Rr. Dervish Hima nr. 1, Tirane.

NENI 9

VITI USHTRIMOR

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti kalendarik.

Perjashtimisht, viti i pare ushtrimor fillon ne daten e themelimit te Shoqerise dhe perfundon me 31 Dhjetor te ketij viti.

Ky Akt Themelimi hartohet dhe nenshkruhet ne 3 (tre) ekzemplare origjinale.

**ORTAKU I VETEM**

Gjergj Skendaj

